



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:253203

Datë: 18.09.2020

Numri i dokumentit: 01125752

P.nr. 1049/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM, me gjyqtarin Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit, SH. A., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr. 1103/19, të dt. 13.11.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të dt. 14.09.2020, në prezencë të Prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha, dhe të pandehurit SH.A., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.18.09.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

SH. A., i lindur me dt. ..., në fsh. ..., K. Pejë, ku edhe banon, nga i ati S. dhe nënës GJ., e gjinisë G., me nr. personal, ka te kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 17 fëmijëve, i papunë, i gjendjes se dobët ekonomike, posedon tel.nr...., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

- Me dt. 20.04.2019, rreth orës 20:08 minuta në rrugën Prishtinë-Pejë pikërisht ne fsh. ...- Pejë nga pakujdesia ka shkel nenin 41 te Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ne atë mënyrë qe përderisa i pandehuri po qarkullonte me veturën e tij te tipit Mitsubishi V20 me targa te regjistrimit ..., kur arrin ne vendin e lartcekur, pa u siguruar mire se me një veprim te tille nuk i pengon pjesëmarrësit e tjerë ne komunikacion, fillon kthimin majtas duke kaluar nga shiriti i djathte i lëvizjes ne shiritin e majte me ç ‘rast ia ndërpret rrugën veturës se tipit BMW me targa ... te cilën e drejtonte i dëmtuari D. N. i cilinë pa mundësi te shmangies se aksidentit ku me skajin e përparme te anës se djathte te veturës e godet ne pjesën anësore te anës se majte tek goma e

pasme, veturën të cilin e drejtonte i pandehuri , e si pasojë e aksidentit përveç dëmeve të konsiderueshme materiale në të automjete, dëmtime të rënda trupore sipas ekspertizës mjekoligjore të punuar për rastin, pëson i dëmtuari D. N., ndërsa lëndime të lehta trupore pësojnë: SH. A., E. A., A. A..

-me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71 par.1, nën par. 1.3, nenit 370 par. 8 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së, nenit 333 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHTË

- Të pandehurit i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohen në rast se i pandehuri brenda periudhës 2 (dy) vjeçare nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit D. N., E. A. dhe A. A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 1103/19, të dt. 13.11.2019, kundër të pandehurit SH.A., për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 14.09.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe të pranishëm kanë qenë prokurori i shtetit Lumturije Hoxha, dhe i pandehuri SH. A..

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris më vepra tjera penale dhe se vullnetarisht e bënë pranimin e fajësisë pa kurrfarë presioni .

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës, dhe ka propozuar që si rrethanë lehtësues të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: procesverbali mbi shikimin e aksidentit me numër të rastit DR-3004-185-19 te dt. 06.05.2019, deklarata e te pandehurit SH. A. e dhen ne polici me dt. 20.04.2019 si dhe deklarata e dhënë ne prokurori me date 08.11.2019, kontrate mbi shitblerjen e veturës , deklarata e te dëmtuarit D. N. e dhënë ne polici me dt. 30.04.2019 si dhe deklarata e dhëne ne prokurori me date 08.11.2019, raportet mjekësore te lëshuara nga Spitali Regjional ne Pejë, fotografitë nga vendi i ngjarjes , ekspertiza e aksidentit te komunikacionit e punuar nga ing. Dip. K. R. dt. 06.09.2019, akt ekspertiza mjeko-m ligjore e punuar nga Dr. N. H. dt. 27.08.2019, si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit SH. A. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri veprën e kryer e ka kryer nga pakujdesia.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike të pandehurit pasi që i njëjti jeton nga te ardhurat që i realizon si blektorë (qoban) dhe nga shitja e kohë pas kohëshme e ndonjë bagëtie, faktin se i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar nga ana e gjykatës dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të

arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

Meqenëse i dënuari është hera e parë që bie ndesh me ligjin, nuk është recidivist, jeton në kushte të vështira ekonomike, gjykata refuzoj propozimin e prokurorit të shtetit për dënimin plotësues-ndalimi i drejtimit të automjetit, për shkak se gjykata vlerëson se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet me nenin 38 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.1049/19 dt. 18.09.2020**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.